



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 1378 Prot.

Lushnje, më 15 / 02 / 2023

RELACION

**KËSHILLIT BASHKIAK  
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TË KUSHTEVE PËR TREGTIMIN NË  
MARKAT**

***Të nderuar zoterinj këshilltarë!***

Mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit , Bashkia Lushnje ka realizuar projekte shumë të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, arsimore, shëndetësore etj duke përmirësuar jetën e banorëve të saj dhe zhvilluar ndjeshëm ekonominë e saj.

Si një zonë me kapacitete të larta të produkteve bujqësore sot Lushnja është një nga furnizuesit kryesorë jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij. Duke parë vendin e rëndësishëm që kemi në tregtimin e produkteve bujqësore, rëndësi i është kushtuar jo vetëm përmirësimit të cilësisë së produkteve por edhe tregtimit të tyre sipas standarteve bashkëkohore.

Në territorin e Bashkisë është ndërtuar nje markate e re me kushtet bashkëkohore të tregtimit. Markata ndodhet në Lagjien “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Besim Nuri”, fal një projekti të Bashkisë ka pësuar transformim total të saj duke plotësuar të gjitha kushtet higjieno sanitare me qëllimin e vetëm të ofrohen produkte të sigurta për banorët e saj.

Tani që ndërtimi i kësaj markate është duke përfunduar është e domosdoshme për mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e saj, miratimin e një rregulloreje e cila garanton përbushjen e detyrimeve, shmangien e konfliktit të interesit, trajtimin e drejtë dhe të barabartë të subjekteve, mbikëqyrjen e tregut dhe respektimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve .

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,ju propozojmë miratimin e këtij relacioni.

Bashkëngjitur kopje e rregullores:

KRYETARI BASHKISË  
ERISELDA SEFA

